

**Akti i Themelimit dhe Statut i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar  
"Phenom Leather" Sh.p.k.**

Sot, ne 17.11.2021, ne Tirane (Shqiperi) bazuar ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", me vullnet te plote dhe te lire te shprehur ne kete akt, Arjol Bajlos si Ortaku i Vetem i Shoqerise "Phenom Leather" Shpk te sapo themeluar, pergatit kete statut si me poshte:

**Neni 1**

**Emri i Shoqerise**

- 1.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar eshte emertuar "Phenom Leather" Shpk.
- 1.2 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar do te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Biznesit ("QKB") me emrin "Phenom Leather" Shpk ("Shoqeria").

**Neni 2**

**Selia e Shoqerise**

- 2.1 Shoqeria "Phenom Leather" Shpk e ka seline ligjore ne adresen: Rruga, Besim Fagu, Nr 10, Tirane, Shqiperi.
- 2.2 Ortaku i Vetem mund te vendose per transferimin e selise se Shoqerise, ose themelimin apo mbylljen e degeve dhe/ose zyrave te perfaqesimit apo zyra administrative brenda territorit te Republikes se Shqiperise dhe / ose jashte saj.

**Neni 3**

**Kohezgjatja e Shoqerise**

- 3.1 Kohezgjatja e Shoqerise fillon nga momenti i regjistrimit te saj prane QKB per nje kohezgjatje te pakufizuar.
- 3.2. Shoqeria fiton personalitet juridik nga momenti i regjistrimit ne QKB Tirane.

**Neni 4**

**Objekti i Shoqerise**

- 4.1. Shoqeria ka per objekt: Punishte artizanale lekure per portofola dhe canta.

**Neni 5**

**Kapitali i Shoqerise**

- 5.1 Kapitali fillestar i Shoqerise eshte 1,000 leke (njemije) i perbere nga 1 kuote e cili zoterohet plotesisht 100% nga Ortaku i Vetem Arjol Bajlos.

Kapitali fillestar i Shoqerise mund te zmadhohet apo zvogelohet dhe eshte teresisht i likuidueshem dhe i nenshkrueshem.

- 5.2 Kapitali i shoqerise muund te zmadhohet ne cdo kohe me nje vendim te Ortakut te Vetem. Ne rast te nje zmadhimi te kapitalit, Ortaku i Vetem do te kete te drejten te nenshkruaj zmadhimin e kapitalit.

Nje zmadhim i mundshem i kuotave te kapitalit te panenshkruar do te mund tu ofrohet per te paleve te treta te interesuara, pervec kur parashikohet ndryshe nga vendimi i Asamblese se



Pergjithshme. Palet e treta te interesuara ne blerjen e aksioneve ne kapitalin e shoqerise duhet te jene me pelqimin e Ortakut te Vetem dhe per kete arsye propozimi i tyre i blerjes duhet te jete miratuar nga Asambleja e Pergjithshme. Ne rast te nje nenshkrimi te pjesshem te kapitalit ajo do te konsiderohet ne te gjitha rastet ne rritje per pjesen e nenshkruar nga Ortaku i Vetem.

- 5.3 Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin pas nje vendimi te Asamblese se Pergjithshme. Ne cdo rast, kapitali nuk do te reduktohet nen minimumin e kerkuar nga ligji. Zvogelimi i kapitalit mbeshtetet nga Ortaku i Vetem.
- 5.4 Kapitali i shoqerise perbehet nga kapitali fillestar i saj, nga pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme dhe nga pasuri te tjera te konsideruara ose qe do te konsiderohen si te nevojshrne per zhvillimin e veprimtarise se Shoqerise.
- 5.5 Kuotat e kapitalit derdhen ne banke nga Ortaku i Vetem, ne llogarine rrjedhese ne emer te Shoqerise.
- 5.6 Kapitali fillestar eshte nenshkruar teresisht nga Ortaku i Vetem i Shoqerise.
- 5.7 Ortaku ka te drejten te terheqe fondet e depozituara si kapital fillestar te Shoqerise, ne rastin ne te cilin Shoqeria nuk regjistrohet ne QKB brenda 6 (gjashte) muajsh nga data e depozitimit te fondit.

#### **Neni 6 Transferimi i kuotave**

- 6.1. Transferimi i kuotave eshte i vlefshem ndaj ortakeve te Shoqerise si me akt midis te gjalleve ashtu dhe me trashegimi, vetem ne rast se rezulton se jane respektuar dispozitat e ketij neni.
- 6.2 Ne rast transferimi te kuotave midis te gjalleve me akt, ortakeve i takon e drejta e parablerjes te kuotave te shoqerise. Ortaku shites si fillim duhet te beje nje oferte ortakeve te tjere me leter rekomande, ne te cilen te percaktoje cmimin e kerkuar per shitjen e kuotes se tij. Ne kete rast secili nga ortaket, ne proporcion me pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerise, gezon te drejten e parablerjes.
- 6.3 Ne rast mosmarveshjesh mbi cmimin e kerkuar, me kerkese te paleve te interesuara, cmimi do te percaktohet nga nje ekspert kontabel i miratuar me shumice te thjeshte nga Asambleja e Ortakeve, i cili do te percaktoje cmimin e shitjes ne baze te vleres reale te kuotave.
- 6.4 Ne rast mosmarveshjeje mbi emerimin e ekspertit kontabel, i cili do te emerohet me shpenzime te seciles pale, me kerkese te pales se interesuar do te zgjidhet nga gjykata e vendit ku ka seline shoqeria.
- 6.5 Eksperti duhet te kryeje vleresimet sipas kriterëve dhe menyrave te parashikuara nga legjislacioni shqiptar,
- 6.6 Pas vleresimit te kuotave nga ana e ekspertit, si shitesi po ashtu edhe blesesi, kane te drejte te terhiqen perkatesisht nga shitja dhe blerja. Ne kete rast shpenzimet e ekspertit do te jene ne ngarkim te pales qe terhiqet.
- 6.7 Ortaku shites i kuotave duhet t'i transferoje keto te fundit me akt te shkruar ortakeve bleses brenda 30 (tridhjete) diteve nga marrja e njoftimit dhe ne rast te vleresimit te bere nga eksperti kontabel, brenda afatit prej 15 (pesembedhjete) dite nga dita e vleresimit.
- 6.8. E drejta e parablerjes duhet te ushtrohet brenda nje periudhe 30 (tridhjete) ditore duke filluar nga data e njoftimit te ofertes ose brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga data e percaktimit te cmimit nga ana e ekspertit kontabel te emeruar. Pasi kane kaluar afatet e mesiperme, shitesi ka te drejten te transferoje tek pale te treta kuotat e tij.



- 6.9. Transferimi i kuotave per shkak trashegimie ndaj trashegimtareve te te ndjerit eshte i kufizuar me dhenien e miratimit e ortakeve te mbledhur ne asamblene e pergjithshme. Ne rast kundershimi te ortakeve per transferimin e kuotave drejt trashegimtareve te te ndjerit, cmimi i shitjes do te caktohet sipas procedurave per transferimin me akt midis te gjalleve si me siper.

#### **Neni 7**

##### **Fitimet e Shoqerise**

- 7.1 Fitimet e Shoqerise i takojne Ortakut te saj te Vetem.  
7.2 Asambleja vendos sipas ligjit per ndarjen ose riqarkullimin e tyre, duke percaktuar edhe menytrat

#### **Neni 8**

- 8.1 Shoqeria do te perdore dhe disponoje pasurine e saj te akumuluar. Ajo mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera, materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se akumuluar tek te tretet. Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria gezon te drejta sikunder cdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj, sipas legjislacionit ne fuqi.

#### **Neni 9**

- 9.1 Shoqeria vepron ne regjimin e prones private dhe merr persiper te drejatat e detyrimet vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise, vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne te.

#### **Neni 10**

##### **Drejtimi dhe administrimi i Shoqerise**

- 10.1 Bejne pjese ne detyrat dhe kompetencat e ortakeve te mbledhur ne Asamblene e Pergjithshme te gjitha ato qe jane parashikuar e rregulluar me ligj, si dhe te listuar ne kete Statut. Nder keto detyra perfshihen:
1. ndryshimi i aktit te themelimit statutit;
  2. miratimi i buxhetit vjetor, te raporteve te administrimit, te inventarit, te bilancit dhe llogarive vjetore;
  3. emerimi e shkarkimi i administratoreve, qofshin ortake ose jo, dhe percaktimi i detyrave dhe kompetencave te tyre, duke percaktuar se qofte per emerimin ashtu edhe per shkarkimin nuk do te jete e domosdoshme te jepet shprehimisht motivi;
  4. miratimi i kredive dhe garancive;
  5. miratimi i tarifave per sherbimet qe kryen Shoqeria;
  6. percaktimi i formes se vules dhe te markes se Shoqerise;
  7. zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise;
  8. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
  9. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
  10. vendimi lidhur me krijimin apo mbylljen e degeve, zyrove te perfaqesimit ose agjensive te Shoqerise;
  11. vendimi per riorganizirnin dhe prishjen e Shoqerise;
  12. vendimi per fillimin apo per zgjidhjen e nje mosmarreshje ligjore ne to cilen eshte e perfshire Shoqeria, duke autorizuar administratorin e Shoqerise per te vepruar;
  13. vendimi per emerimin dhe shkarkimin e likuidatoreve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar apo te konsulenteve te tjere, qofte persona fizike apo juridike;
  14. vendimi per ndarjen e kotave dhe per anulimin tyre;
  15. vendimi per miratimin dhe ndryshimin e procedures per mbledhjen e asamblese;
  16. vendimi per dhenien ose revokimin e prokurave te perfaqesimit te Shoqerise;



- 17.vendimi per transferimin ose shitjen e kuotave to Shoqerise;
- 18.vendimi per ceshtje te tjera te parashikuara me ligj apo nga statuti;
- 19.marrjen e cdo vendimi tjetër qe nuk i është deleguar ndonje organi tjetër.

## **Neni 11**

### **Asambleja e Pergjithshme**

- 11.1 Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.
- 11.2 Asambleja e Pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi te derguar nga administratori drejt Ortakut to Vetem me shkrese ose, sipas zgjedhjes se administratorit, nepermjet postes elektronike. Adresat elektronike email te ortakeve regjistrohen ne bazen e te dhenave te Shoqerise.
- 11.3 Njoftimi per mbledhjen e asamblese duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe duhet t'u dergohet te gjithëve jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- 11.4 Kur asambleja e pergjithshme nuk është thirrur sipas modalitetit te lartpermendur, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se te gjithë ortakët jane dakord per te marre keto vendime, pavaresisht nga mungesa e njoftimit.
- 11.5 Vendimet e asamblese se pergjithshme merren ne forrnen e vendimeve me shkrim, Te gjitha vendimet e Asamblese duhet te regjistrohen ne procesverbale.
- 11.6 Pjesemarrja apo votimi ne Asamblene e Pergjithshme mund te kryhet edhe nepermjet mjeteve elektronike ne menyren e parashikuar ne ligj. Procesverbali i vendimeve duhet t'i dorezohet administratorit, i cili e regjistron ne regjistrin e vendimeve, qe do te ruhet ne seline ligjore te Shoqerise nen kujdesin e administratorit.
- 11.7 Asambleja e pergjithshme mund te mblidhet edhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise. Ne kete rast vendimet e asamblese se pergjithshme te marra jashte territorit te Republikes se Shqiperise, do t'i nenshtrohen procedurave te parashikuara nga ligji shqiptar per njohjen e dokumenteve te huaja ne Shqiperi dhe duhet te jene ne perputhje me parashikimet e ketij statuti per sa i takon kuorumit dhe shumices ne marrjen e vendimeve.
- 11.8 Asambleja e Pergjithshme, pervec rasteve parashikimeve te nenit 11.9 te ketij Statuti, vendos me voten pro te shumices se ortakeve, nese ortakët qe marrin pjese ne mbledhje me te drejte vote perfaqesojne me shume se 30% (tridhete per qind) te kapitalit te shoqerise.
- 11.9 Asambleja e Pergjithshme vendos me 75% (shtatedhjetepese per qind) te votave te ortakeve, nese ortakët qe marrin pjese me te drejte vote perfaqesojne me shume se 50% (pesedhete per qind) te kapitalit te Shoqerise. Ceshtjet per te cilat kerkohet shurnica e kualifikuar jane:
  - a) Ndryshimet e Statutit;
  - b) Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit;
  - c) Shperndarja e fitimeve;
  - d) Riorganizimi, prishja dhe likuidimi i Shoqerise dhe degeve te saj.

## **Neni 12**

- 12.1 Administratori i Shoqerise është:
  - 12.1 Arjol Bajlos, shtetas shqiptar, lindur ne Bilisht, Devoll, me date 14.08.1995, i identifikuar nepermjet ID Nr.Personal J50814040V, me zotesi te plote per te vepruar;
  - 12.2 Administratori i Shoqerise i ushtron kompetencat e tij duke aplikuar politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me ligjet ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.
  - 12.3 Administratori emerohet per nje afat 5 (pese) vjecar duke filluar nga data e emerimit, me te drejte rimerimi nga Asambleja e Pergjithshme.



- 12.4 Asambleja e Pergjithshme Mund te vendose te revokoje administratorin para mbarimit te mandatit. Administratori ka te drejte te jape doreheqjen e parakohshme, perpara mbarimit te mandatit, me njoftim drejtuar Asamblese se Pergjithshme sipas procedurave te parashikuara ne ligj.
- 12.5 Asambleja e Pergjithshme mund te emeruje edhe me shume se nje administrator, te cfaredo kombesie dhe te jashtem per Shoqerine. Ne rastin e emerimit te nje apo me shume administratoreve ne fuqi, secili nga administratoret mund te ushtroje te gjitha tagrat e perfaqesimit dhe te firmes ashtu si rezultojne ne aktin e emerimit te tyre. Secili nga ato do te jete individualisht pergjegjes per permbushjen e funksioneve te dhena nga ligji per administratorin dhe do ti komunikojte te tjereve ose administratorit tjetër veprimet te kryera nga ai.

### Neni 13

- 13.1 Administratoret kryejne detyrat e percaktuara nga Ortaku i Vetem i Shoqerise ne kete Statut dhe te gjitha ato detyra te parashikuara dhe te rregulluara me ligj. Nder keto pershihen detyrat e renditura me poshte.
1. Te veproje dhe te nenshkruaje ne emer te Shoqerise.
  2. Te hartojte rregulloren e brendshme te Shoqerise, qe do te miratohet ne Asamblene e Pergjithshme.
  3. Te marre vendime lidhur me kredite qe do te merren dhe dhenien e garancive.
  4. Te perpunoje dhe te paraqese per miratim ne asamblene e pergjithshme raporte per ecurine e aktivitetit te shoqerise dhe te bilancit te mbylljes se aktivitetit financiar te vitit paraardhes, sipas asaj qe parashikohet ne ligj.
  5. Te mbaje ne rregull regjistrin e vendimeve te asamblese se pergjithshrne,
  6. Administratoret jane pergjegjes kundrejt shoqerise dhe te treteve per shkeljet e ligjit apo te normave te statutit qe mund te ndodhin gjate ecurise se aktivitetit, sipas legjislacionit shqiptar,
  7. Te kryeje te gjitha aktivitetet e administrimit te aktivitetit tregtar te shoqerise, duke aplikuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme.
  8. Te perfaqesojte Shoqerine.
  9. Te kujdeset per mbajtjen e dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise me korrektesi dhe saktesi.
  10. Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit.
  11. Te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
  12. Te raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoqerise.
  13. Te emeruje financiere e konsulente per problemet e shoqerise. Financieri nxjerr rregullisht indikatoret financiare tre-rnujore, 6-mujore dhe vjetore, per aktivitetin e kryer te Shoqerise.
  14. Te mire administroje Shoqerine.
  15. Te lidhe marreveshje me te trete ne kufijte e objektit te aktivitetit te Shoqerise dhe te kompetencave te percaktuara nga ortaket.
  16. Te zbatoje rregulloren e brendshme te Shoqerise.
  17. Te jete pergjegjes per demet e shkaktuara Shoqerise nga veprimet e tij,
  18. Te shperblehet per punen qe kryen sipas marreveshjes me ortaket themelues.
  19. Te informohet dhe te beje propozime per cfaredolloj gjeje qe e vlereson si te rendesishme per shoqerine.
  20. Te kryeje te gjitha veprimet bankare ne lidhje me llogarine e shoqerise.
  21. Administratoret kane te drejte dhe detyre te therrasin asamblene e pergjithshrne, sipas dispozitave te percaktuara ne nenet 12 dhe 13 te ketij statuti dhe te ligjit aty ku nuk parashikohet shprehimisht ne statut.



**Neni 14**  
**Te Drejtat e Shoqerise**

14.1 Shoqeria ka te drejte:

1. te kryeje veprimtari ne baze te interesave qe ka ne perputhje me objektin e veprimtarise;
2. te siguroje pasurine e vet;
3. te marre kredi ne leke dhe ne valute nga Bankat vendase ose te huaja ne baze te rregullave ligjore;
4. te perfitoje nga favoret qe i njej Legjislacioni shqiptar lidhur me tatimet dhe te tjera;
5. te investoje kudo ne Shqiperi, me te ardhurat qe realizon gjate ushtrimit te aktivitetit te saj;
6. te punesoje punetore, vendas ose te huaj;
7. te eksportoje lirisht valuten qe ka realizuar nga fitimet e saj.

**Neni 15**  
**Detyrat e Shoqerise**

15.1 Shoqeria ka per detyre:

1. te siguroje kapitalin e shoqerise ne formen dhe kohen e duhur;
2. te jape garanci per sherbimet qe kryen shoqeria;
3. te siguroje punonjesit e saj;
4. te plotesoje detyrimet fiskale dhe sociale qe ka ndaj shtetit, si edhe detyrimet kontraktuale ndaj cilitdo.
5. te pajiset me leje/autorizime te mundshme, nese kerkohen nga ligji, per te zbatuar objektin e veprimtarise se saj;
6. te respektoje standardet si dhe te gjitha rregullat qe lidhen me veprimtarine e saj.

**Neni 16**  
**Marredheniet ekonomike financiare te Shoqerise**

16.1 E gjithë veprimtaria e shoqerise per plotesimin e objektit te veprimtarise se saj, pasqyrohet ne bilancin ekonomik te saj.

**Neni 17**

17.1 Ne seline e shoqerise mbahet dokumentacioni financiar, ne baze te te cilit, brenda dates 31 mars te cdo viti nxirret bilarici vjetor i Shoqerise.

**Neni 18**

18.1 Viti financiar fillon cdo vit me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te te njejtit vit.

**Neni 19**

19.1 Shoqeria mban llogarine e saj ne Banke. Llogarite mbahen ne Leke dhe/ose Euro dhe pasqyrohen ne librat kontabel perkates.

**Neni 20**

20.1 Nga fitimet e realizuara gjate vitit financiar, Shoqeria, pasi ben zbritjen e humbjeve te vitit te meparshern, le menjane 5% te fitimit, me te cilin krijohet fondi "Rezerve e domosdoshme",

**Neni 21**  
**Dispozita te vecanta**



21.1 Shoqeria ka vulen e saj me perrnasa te zakonshme, to realizuar sipas parashikimeve te ligjit ne fuqi dhe mund te kete nje marke te veten. Ne rast te krijimit te nje faqe interneti, mund te deklarohet ne menyre vullnetare ne QKB.

#### **Neni 22 Shderrimi**

22.1 Shderrimi i Shoqerise ne shoqeri te llojeve te tjera, mund te behet me vendim te ortakeve themelues sipas menyrave te parashikuara ne ligj.

#### **Neni 23 Prishja e Shoqerise**

23.1 Shperberja e shoqerise, mund te vije per shkaqet e parashikuara ne nenin 99 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 dhe per arsyet si me poshte:

- kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- me vendim te asamblese se pergjithshme;
- me hapjen e procedurave te falimentimit;
- nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kornbetare te Regjistrimit";
- me vendim te gjykates;
- humbja e kapitalit te shoqerise;

Ne keto raste, ortaket e shoqerise vendosin mbi menyren e likuidimit dhe caktojne nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar edhe detyrat. Administratori dhe likuidatori jane pergjegjes per ruajtjen e pasurise se Shoqerise derisa ajo tiu dorezohet personave perkates fizike e juridike, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet qe ka shoqeria ndaj personave te trete.

23.2 Ne rast se fondet e disponueshme, rezultojne to pamjaftueshem, per shlyerjen e detyrimeve te Shoqerise, likuidatori mund t'i kerkoje ortakeve themelues te Shoqerise qe te derdhe teresisht kuotat qe u takojne.

#### **Neni 24 Ligji i aplikueshem dhe Juridiksioni**

24.1 Te gjitha konfliktet qe mund te lindin midis ortakeve te Shoqerise, midis ortakeve dhe Shoqerise, midis Shoqerise dhe administratorit do ti nenshtrohen per zgjidhje gjykates kompetente te Republikes se Shqiperise ne perputhje me ligjet shqiptare ne fuqi.

#### **Neni 25**

25.1 Ky statut perpilohet ne 2 (dy) ekzemplare ne gjuhen shqipe, te nenshkruara rregullisht nga Ortaku i Vetem.

Nenshkruar ne Tirane me date 17.11.2021  
Ortaku i Vetem i Shoqerise

Arjol Bajlos

